



**RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN  
E SISTEMIT TË BRENDSHËM TË SIGURIMIT TË CILËSISË**

## **SHKURTESA**

<b>UAMD</b>	-	<i>Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës</i>
<b>SA</b>	-	<i>Senati Akademik</i>
<b>KPGSC</b>	-	<i>Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve dhe Cilësisë</i>
<b>NjBSC</b>	-	<i>Njësia e Brëndshme e Sigurimit të Cilësisë</i>
<b>DKSC</b>	-	<i>Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë</i>
<b>ASCAL</b>	-	<i>Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë</i>
<b>SSC</b>	-	<i>Sistemi i Sigurimit të Cilësisë</i>
<b>SBSC</b>	-	<i>Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë</i>
<b>SJSC</b>	-	<i>Sistemi i Jashtëm i Sigurimit të Cilësisë</i>
<b>GVB</b>	-	<i>Grupi i vlerësimit të brendshëm</i>
<b>GVJ</b>	-	<i>Grupi i vlerësimit të jashtëm</i>
<b>KIAL</b>	-	<i>Koordinatori i Institucionit të Arsimit të Lartë pranë ASCAL</i>
<b>KoP</b>	-	<i>Koordinatori i Programit</i>
<b>TKP</b>	-	<i>Treguesit kyç të performancës</i>
<b>KA</b>	-	<i>Komisioni i Akreditimit</i>

- RVB** - *Raporti i Vlerësimit të Brëndshëm*
- RVJ** - *Raporti i Vlerësimit të Jashtëm*
- DA** - *Dosja e Akreditimit*
- SUE** - *Standardet dhe Udhëzimet Europiane mbi Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë*

PJESA E PARË  
**QËLLIMI, FUSHA E ZBATIMIT, STRUKTURAT PËRGJEGJËSE**

Neni 1

**Qëllimi dhe baza ligjore**

Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ka për qëllim të përcaktojë, funksionimin dhe organizimin e këtij sistemi, përmes rregullimit dhe standardizimit të vlerësimit të proceseve në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Kjo rregullore synon, përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përmbushur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD), si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë.

Rregullorja ka për qëllim, zhvillimin e cilësisë përmes përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, miratimit të treguesve të cilësisë në kuadër të “vlerësimit të jashtëm”, si dhe përmes aplikimeve përkatëse të tyre, duke respektuar çdo hap të nevojshëm për këtë proces dhe për çdo proces tjetër që lidhet me cilësinë e institucionit tonë arsimor, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ajo bazohet në :

- Ligjin Nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 103,104, 106 dhe 46;
- Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, miratuar me VKM Nr.531, datë 11.9.2018 ;
- Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (SUE) ;
- Statutin e Universitetit « Aleksandër Moisiu » Durrës ;
- Rregulloren e Universitetit « Aleksandër Moisiu » Durrës ;
- Manualin e ASCAL për Sistemin e Brendshëm të Cilësisë;

## Neni 2

### Strukturat përbërëse të Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe përgjegjësitë e tyre

Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë:

- Senati Akademik
- Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC)
- Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë (NjSBC)
- Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL)
- Drejtorja e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC)

Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:

- Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti)
- Grupi i Vlerësimit të Brëndshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.)
- Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.)

1. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brëndshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD, duke shërbyer si një garanci e shtuar në kuadrin e SBSC.

KPGSC, në rolin e një komisioni të përhershëm, kërkon në mënyrë të vazhdueshme informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe programeve të studimit nga NjSBC. Kjo e fundit, ka si funksion kryesor bashkëpunimin dhe asistimin e këtij Komisioni.

KPGSC mbikqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm.

DKSC mund të përcjellë sipas rastit, apo pas kërkesës së KPGSC dokumentacione apo informacione të ndryshme që zotërohen nga Drejtorja.

Detyrat kryesore të Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit janë si më poshtë:

a) Përcakton standardet e cilësisë institucionale, bazuar në Kodin e Cilësisë dhe eksperiencat pozitive kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ja propozon ato Senatit Akademik për miratim.

- b) Monitoron dhe udhëheq realizimin e standardeve institucionale të cilësisë dhe të programeve të studimit nga strukturat përkatëse
  - c) Monitoron aktivitetin e komisioneve të vlerësimit të brendshëm tek njësitë kryesore dhe në Rektorat.
  - d) I propozon për miratim Senatit Akademik raportin e brendshëm të cilësisë së institucionit.
  - e) I propozon Senatit akademik për miratim instrumentat e cilësisë, format e publikimit të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.;
2. NjBSC ne nivel Fakulteti, realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC ne nivel Institucional. Në realizimin e këtyre objektiveve NjBSC në nivel Fakulteti kërkon dosjen e programeve të studimit nga koordinorët e programeve. Në realizimin e objektiveve të akreditimit NjBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NjBSC në nivel Institucional. Dokumentacioni i NjBSC në nivel Fakulteti i përcillet Dekanit dhe NjBSC në nivel Institucional.

## PJESA E DYTË SISTEMI I SIGURIMIT TË CILËSISË

### Neni 3

#### **Objektivat e sigurimit të cilësisë (SSC)**

Sistem i sigurimit të cilësisë (SSC) ose korniza e sistemit të sigurimit të cilësisë, në funksion të kësaj rregulloreje, është sistemi zyrtar i menaxhimit që përdoret për fuqizimin e një IAL. SSC përcakton pritshmëritë, synimet mbi rritjen e standardeve të arsimit dhe ka për qëllim të garantojë që, procedurat që garantojnë cilësinë të jenë zbatuar.

SSC fillon me vendosjen e objektiveve (nga strukturat e sipërpërmendura) ndaj të cilave duhet të bëhet një krahasim i performancës në mënyrë të vazhdueshme. Krahasimi realizohet nëpërmjet procedurave të vetëvlerësimit ose vlerësimit të jashtëm. Në çdo rast, DKSC pasi realizon vlerësimin përkatës, duhet të procedojë me planifikimin e veprimeve (për përmirësime apo shtesa) të mundshme dhe të propozojë masat për rishikimin e ndryshimeve që duhen realizuar.

Strukturat e vlerësimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe departamenti, i përcjellin brenda afateve të vendosura DKSC- së informacionet përkatëse, duke u konsultuar edhe paraprakisht me të, në rastet kur gjykohet e nevojshme.

#### Neni 4

### **Menaxhimi i zhvillimit të Cilësisë**

NjëBSC krijon një sistem kuadër cilësie që, përcakton mënyrën se si menaxhohet zhvillimi i cilësisë, shpjegon si mblidhen evidencat dhe si vlerësohet cilësia e shërbimit, në mënyrë që të analizohen nevojat dhe të vendosen synimet për zhvillimin e cilësisë. Sistemet e sigurimit të cilësisë në kuadër të kësaj rregulloreje i referohen:

- **Procese të brendshme** – Duke vënë në funksionim sisteme që ofrojnë performancë dhe i përgjigjen pyetjeve mbi saktësinë dhe efikasitetin e procedurave të sigurimit të cilësisë.
- **Procese të jashtme** – Duke ju referuar qëllimit, vlerave dhe objektivave të institucionit, të cilat i referohen edhe dokumentave strategjikë kombëtarë dhe studimeve mbi kërkesat e tregut. Gjithashtu, edhe mundësi mbi shkëmbimet studentore, stafit akademik apo atij administrativ në kuadër të projekteve ndërkombëtare.

#### Neni 5

### **Standardet kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë**

UAMD i përmbahet Standardeve Europiane kryesore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, si më poshtë:

#### *Standardi 1: Politika për sigurimin e cilësisë*

Institucioni duhet të ketë një politikë për sigurimin e cilësisë e cila është bërë publike dhe është pjesë e menaxhimit strategjik. Palët e interesuara brenda institucionit duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë këtë politikë nëpërmjet strukturave dhe proceseve të përshtatshme duke përfshirë edhe palë të interesuara jashtë institucionit.

#### *Standardi 2: Hartimi dhe miratimi i programeve*

Institucioni parashikon procese për hartimin dhe miratimin e programeve që ofron. Programet duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të përmbushin objektivat dhe rezultatet e të nxënit. Diploma e dhënë për programin duhet të përputhet me nivelin e kornizës kombëtare dhe europiane të kualifikimeve.

#### *Standardi 3: Të nxënit, mësimdhënia dhe vlerësimi me në qendër studentin*

Institucioni garanton se programet zhvillohen në mënyrë të tillë që nxësin studentët të luajnë një rol aktiv në krijimin e procesit të të nxënit dhe se vlerësimi pasqyron këtë qasje.

#### *Standardi 4: Pranimi i studenteve, progresi, njohja e krediteve dhe diplomimi i tyre*

Institucioni duhet të paracaktojë dhe të publikojë rregulla për të gjitha fazat e “jetës studentore”, pranimin, progresin, njohjen e krediteve dhe diplomimin.

*Standardi 5: Personeli akademik*

Institucioni duhet të garantojë cilësinë e personelit akademik. Institucioni duhet të zbatojë procedura të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e personelit akademik.

*Standardi 6: Burimet e të nxënës dhe mbështetja për studentin*

Institucioni duhet të ketë fondet e duhura për veprimtaritë e të nxënës dhe të mësimdhënies dhe të garantojë se burimet e të nxënës dhe mbështetja për studentin janë siguruar.

*Standardi 7: Menaxhimi i informacionit*

Institucioni duhet të garantojë se mbledh, analizon dhe përdor informacionin e përshtatshëm për menaxhimin efektiv të programeve dhe veprimtarive të tjera.

*Standardi 8: Informimi i publikut*

Institucioni duhet të publikojë informacion për veprimtaritë që kryen, përfshirë programet e studimit, i cili duhet të jetë i qartë, i saktë, objektiv, i përditësuar dhe lehtësisht i arritshëm.

*Standardi 9: Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi periodik i programeve*

Institucioni duhet të monitorojë dhe të vlerësojë periodikisht programet që ofron dhe të garantojë se janë përmbushur objektivat e tyre si dhe nevojat e studentëve dhe të shoqërisë. Këto vlerësime duhet të çojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve. Veprimet e ndërmarra si rezultat i vlerësimit dhe përmirësimit duhet t’u komunikohen palëve të interesuara.

*Standardi 10: Sigurimi i jashtëm ciklik i cilësisë*

Institucioni duhet t’i nënshtrohet sigurimit të jashtëm të cilësisë në baza ciklike në përputhje me standardet dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane.

## Neni 6

### **Sigurimi i cilësisë**

#### **Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet:**

a) Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri, zakonisht javën e 13 dhe të 14. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamentit, si dhe dekanëve përkatës nga DKSC në Rektorat.



Brenda muajit Shtator, fakultetet duhet të dërgojnë tabelën përkatëse, sipas Aneksit IV të miratuar me Vendim Rektorati, me rezultatet e vlerësimit të stafit akademik për të dy semestrat, sipas departamenteve, si dhe detyrimet që duhet të plotësojnë pedagogët me vlerësim jo të mirë, sipas shkallës së përcaktuar në Aneksin IV.

Pyetëtori propozohet nga KPGSC dhe miratohet nga Senati Akademik.

b) Vlerësimit të përgjegjësit të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë, duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore.

Ky pyetësor zhvillohet në fund të semestrit të dytë, brenda muajit Qershor, dhe së bashku me vlerësimin e studentëve i vihet në dispozicion Rektoratit.

#### **Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve të institucionit (UAMD) sigurohet nëpërmjet:**

- a) Pyetësorit të studentëve, të cilët vlerësojnë institucionin;
- b) Pyetësorit të stafit akademik, i cili vlerëson institucionin;
- c) Pyetësorit të stafit administrativ, i cili vlerëson institucionin;
- d) Vlerësimit të drejtuesit të njësisë kryesore për stafin administrativ që ai drejton.

Cilësia e shërbimeve të ofruara nga institucioni për studentët matet kryesisht nga hartimi dhe zbatimi i politikave për shërbimet inovative në universitet, infrastrukturës, faciliteteve, bibliotekës, shërbimeve nga ana e sekretarive mësimore, teknologjisë së informacionit etj.

Ky vlerësim realizohet një herë në vit, zakonisht brenda muajit Qershor të çdo viti akademik.

Procesi i shpërndarjes së pyetësorëve dhe mbledhjes së të dhënave realizohet nga DKSC e cila ja paraqet rezultatet e tyre Rektorit, Administratorit, KPGSC dhe Senatit Akademik për analiza të mëtejshme.

Edhe në këtë rast, formati i pyetësorëve propozohet nga KPGSC dhe miratohet nga Senati Akademik.

#### **Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit sigurohet nëpërmjet:**

- a) përcaktimit të kriterëve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit të programeve sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, duke u bazuar në modelet e brëndshme të UAMD;
- b) standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programeve të studimit sic përcaktohen në kornizën europiane të sigurimit të cilësisë dhe kodit të cilësisë;
- c) rregullores së studimeve për çdo program;

- d) cilësisë dhe numrit të kërkuar të personelit akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin;
- e) politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore;
- f) infrastrukturës mësimore;
- g) ndërkombëtarizimit të programeve;
- h) monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit.

**Vlerësimi i cilësisë së studentëve sigurohet nëpërmjet:**

- a) kriterëve të pranimit duke respektuar karakteristikat e programit të studimit;
- b) kriterëve të vlerësimit të studentëve;
- c) kriterëve të vlerësimit të punimeve të diplomave;
- d) treguesve të rezultateve të të nxënit;
- e) treguesve të shërbimeve mbështetëse për studentët;
- f) treguesve të punësimit të të diplomuarve;
- g) mbështetjes së mobilitetit të studentëve;
- h) njohjes së studimeve.

**Vlerësimi i cilësisë së personelit sigurohet nëpërmjet:**

- a) kriterëve të rekrutimit;
- b) përshkrimit standart dhe specifik të punës;
- c) treguesve të performancës nga vlerësimi i studentëve dhe eprorit;
- d) vlerësimit të performancës nga eprori;
- e) mbështetjes së mobilitetit;

f) standarteve të promovimit;

g) nivelit të trajnimit.

**Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor sigurohet nëpërmjet:**

a) planit strategjik të kërkimit shkencor;

b) procedurës së monitorimit të treguesve dhe të vlerësimit të kërkimit shkencor;

c) sistemit të informimit për kërkimin shkencor.

Sigurimi i cilësisë matet përmes të dhënave dhe treguesve të ndryshëm cilësorë dhe sasiorë të cilët analizohen dhe rishikohen nga strukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë në shumë nivele **(Shih Aneksin II)**.

Neni 7

**Vlerësimi i njohurive dhe dijeve përmes teknologjisë**

Eliminimi i formave të ndryshme të abuzimit dhe rritja e transparencës gjatë vlerësimit të provimeve, testeve, dijeve dhe aftësive profesionale, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimatit është një standard cilësie që duhet përdorur nga ana e stafit akademik, si për vlerësimin e provimeve të ndërmjetme, ashtu edhe për ato përfundimtare.

Pedagogët mund të përfshijnë në formatin e testit edhe pyetje me alternativa të cilat korrigjohen në formë të automatizuar, me skanera optikë dhe programe kompjuterike të posacme, duke shkurtuar kohë në korrigjimin e provimeve, si dhe duke ofruar mundësinë e saktësisë maksimale, transparencës dhe gjenerimit të raporteve, të cilat i vijnë në ndihmë pedagogëve për të patur një pasqyrë sa më të plotë të rezultateve të studentëve dhe për të bërë krahasimet dhe analizat e nevojshme.

PJESA E TRETË  
**MISIONI, FUNKSIONET DHE ROLI I NJBSC**

Neni 8

**Misioni i NjBSC**

Misioni kryesor i NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira në SSB.

Ligji për Arsimin e Lartë përcakton krijimin e një Njësie për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NjBSC) për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e kërkesave arsimore. NjBSC-ja në nivel institucional ngrihet me Urdhër të Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD).

Neni 9

**Roli dhe funksionet e NjBSC në nivel institucional**

NjBSC ngrihet me Urdhër të Rektorit dhe ka shtatë anëtarë, nga të cilët, një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD-së, drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, si dhe një student.

1. Detyrat kryesore të NjBSC-së përfshijnë:

- a) Përgatitjen e raporteve periodike, të vetëvlerësimit të cilët i propozohen Senatit Akademik për miratim nga KPGSC. SBSC është një element kryesor i procesit të administrimit të arsimit të lartë që fakultetet dhe NjBSC duhet të kryejnë sistematikisht dhe në mënyrë të vazhdueshme. NjBSC monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standardet e fakulteteve dhe njësive të tjera të institucionit, sipas sistemit dhe mekanizmit të krijuar, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, në bazë të kriterëve dhe standardeve të paracaktuara në Kodin e Cilësisë dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.
- b) Rritjen e ndërgjegjësimit të brendshëm mbi çështjet e cilësisë. Ajo realizon informimin dhe ndërgjegjësimin e fakulteteve dhe njësive bazë për statusin e tyre, që çon në përcaktimin e metodave për përgatitjen e programeve që synojnë zhvillimin e cilësisë,

për të arritur qëllimet e vendosura nga vetë NjBSC-ja, me miratimin e KPGSC-së dhe Senatit Akademik.

- c) Ka për detyrë të evidentojë pranë fakulteteve dhe njësive të tjera pranë UAMD-së pikat e tyre të forta dhe të dobëta, së bashku me sugjerimet e marra për zhvillimin e veprimtarive të tyre për të përmirësuar më tej pikat e forta dhe për të minimizuar në mënyrë të vazhdueshme dobësitë.
- d) NjBSC në nivel institucional realizon misionin e saj në bashkëveprim me NjBSC-të në nivel Fakulteti.
- e) Merr masa parapërgatitore për vlerësimin e jashtëm të Cilësisë. Vetëvlerësimi duhet të lidhë sigurimin e brendshëm me sigurimin e jashtëm të cilësisë. Raporti vjetor dhe raporti i vetëvlerësimit, duhet të gjenerojnë një dokument bazë për vizitat në terren të agjencisë së vlerësimit të jashtëm (ASCAL) për çështje të monitorimit dhe akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.
- f) Angazhohet në trajnimin dhe zhvillimin profesional për çështjet e “cilësisë”, si dhe kompetencave të tjera funksionale të stafit akademik dhe atij administrativ.

2.NjBSC-së kryen funksionet e mëposhtme:

- a) **Mbështet dhe ofron ekspertizë.** NjBSC kryen takime pune rregullisht me çdo fakultetet dhe çdo departament dhe ftohet nga ana e tyre që të ofrojë ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, si dhe në asistimin e NjBSC ne rang fakulteti. Ekspertiza duhet të përqendrohet rreth aplikimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë për të vlerësuar në mënyrë eksplicite procesin e mësimdhënies, të nxënit, si dhe metodave moderne të vlerësimit të studentëve me qëllim promovimin e një qasjeje interaktive me në qendër studentin.
- b) **Bashkërendon.** NjBSC në nivel institucional, kur procesi i delegohet NjBSC-së pranë fakulteteve, kryen një rol bashkërendues dhe mund të shtrihet edhe në njësi të tjera në universitet kur NjBSC-ja konsiderohet e lidhur me funksione të tjera si zhvillimi i personelit dhe mbledhja/analiza e të dhënave institucionale.
- c) **Interpreton** detyrimet kombëtare dhe ato ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë. Ajo është përgjegjëse dhe ka për detyrë të interpretojë detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë dhe t'i përshtasë ato në kontekstin institucional të UAMD-së. NjBSC-ja garanton që këto detyrime të njihen dhe përfshihen nga IAL.

- d) Monitoron.** NjBSC-së ofron udhëzime, mbledh informacione, evidenton probleme, përmes informacionit të mbledhur nga drejtoria përgjegjëse në rektorat për sigurimin e cilësisë, si dhe strukturave të tjera përgjegjëse të institucionit.

Zgjidhjet e propozuara nga NjBSC-ja mbi problematikat e evidentuara, në varësi të nivelit të problemit, përmes Rektorit, mund t'i kalojnë për shqyrtim dhe miratim Senatit Akademik ose KPGSC-së.

- e) Lehtëson:** NjBSC-ja duhet të lehtësojë krijimin e një mjedisi të favorshëm me studentin në qendër, për arsimim cilësor dhe zhvillimin e stafit akademik për të përvetësuar njohuritë dhe teknologjitë e nevojshme për një proces me pjesëmarrje aktive gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies.

- f) Siguron** informacion për cilësinë tek aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të universitetit. NjBSC-ja siguron shpërndarjen e informacionit lidhur me treguesit e cilësisë së institucionit për aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në zbatim të legjislacionit Shqiptar.

1. Gjithashtu, në funksion të realizimit të funksionit të saj institucional NjBSC-ja duhet:

- a) Të hartojë dhe zbatojë një manual procedurash që përshkruajnë strukturën e institucionit dhe proceset për sigurimin e cilësisë;
- b) Të specifikojë kriteret për përzgjedhjen dhe formatet e treguesve, të standardeve dhe të objektivave;
- c) Të përgatisë formularët standardë për çështje të tilla si pyetësorët për studentët, administratën dhe stafin akademik, si dhe atyre alumni;
- d) Të këshillojë mbi procedurat operative për planifikimin dhe zbatimin e proceseve të cilësisë.

## NENI 10

### **Drejtoria e Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë**

1. Të organizojë punën për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe shpërndarjen e formularëve standardë për çështje të tilla si pyetësorët për studentët, administratën dhe stafin akademik, si dhe atyre alumni, bazuar në formatet e miratuara nga NjSBC dhe KPGSC dhe udhëzimet përkatëse.
2. Administron dokumentacione që lidhet me sigurimin e cilësisë për të gjithë universitetin dhe bazuar në kërkesa sipas rastit nga NJSBC, kërkon informacione zyrtare nga fakultetet mbi treguesit e cilësisë që lidhen me fushën akademike apo kërkimore shkencore.
3. Përpunon pyetësorët e vlerësimit të pedagogëve dhe institucionit nga studentët dhe i shpërndan rezultatet NJSBC-së dhe të gjitha strukturave përkatëse.

4. Asiston NJSBC në çështje teknike dhe logjistike duke siguruar informacione të vazhdueshme mbi sigurimin e cilësisë në UAMD.
5. Angazhohet në zbatimin e axhendave dhe njoftimeve përkatëse të strukturave që marrin pjesë në takimet që ekspertët e jashtëm dhe ASCAI zhvillojnë gjatë vizitave në kuadër të proceseve të akreditimit.
6. Të mbledhë dhe të ruajë sistematikisht raportet mbi ecurinë, përfshirë të dhënat mbi treguesit dhe objektivat që do të kërkohen për analizën dhe raportimin e cilësisë së standardeve dhe kurrikulave.
7. Të angazhohet në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit përkatës për hartimin e Raportit Vjetor të UAMD, sipas Udhëzimit Nr. 5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementëve të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të Institucioneve të Arsimit të Lartë", i ndryshuar.
8. I Propozon NjBSC-së çështje apo tematika të ndryshme që lidhen me sigurimin e cilësisë për t'u trajtuar më tej në agjendat e takimeve.
9. Përgatit raportin vjetor që vlerëson cilësinë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore në nivel të brendshëm dhe mund të hartojë edhe raporte të tjera publike, sipas kërkesave ligjore dhe nënligjore dhe ja përcjell për shqyrtim dhe miratim NjSBC-së.

#### Neni 11

#### **Funksionet e koordinatorit të programit të studimit**

Koordinatori i programit ka një rol kyç në sigurimin e cilësisë së programeve akademike në UAMD dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve në universitet.

Detyrat e koordinatorit të programit janë si më poshtë:

1. Raporton pranë dekanit dhe NjBSC-së mbi cilësinë dhe standardet e programit që mbikëqyr.
2. Përgatit raporte vjetore, dhe kur kërkohet nga NjBSC-ja gjatë një procesi akreditimi, mbi programin që mbikëqyr, duke u bazuar në formatet e përcaktuara nga NjBSC-ja.
3. Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut mbi programin që mbikëqyr.
4. Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme dosjen e programit që mbikëqyr.
5. Në bashkëpunim me koordinatorin e departamentit për kërkimin shkencor, përgatit një raport vjetor, dhe kur kërkohet nga NjBSC-ja gjatë një procesi akreditimi, mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore duke vlerësuar :
  - a) Numrin e publikimeve në pesë vitet e fundit të stafit akademik të angazhuar në departamentin ofrues të programit.

b) Numrin e citimeve nga autorët e huaj (duke u bazuar në databazat e citimeve dhe faktorit të impaktit) të artikujve të publikuar nga stafi akademik në departamentin ofrues të programit.

c) Numrin e projekteve të propozuara dhe realizuara nga departamenti dhe/ose stafi përbërës i tij.

d) Numrin e konferencave dhe aktiviteteve shkencore të organizuara nga departamenti dhe/ose fakulteti, që kanë në fokus tematikat e programit të ofruar.

## Neni 12

### **Funksioni i Grupit të Vlerësimit të Brendshëm**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ngrihet gjatë procesit të akreditimit të programit nga dekani i fakultetit ku programi ofrohet dhe nën mbikëqyrjen e NjBSC-së harton draft-raportin e Vlerësimit të Brendshëm. GVB-ja përbëhet nga :

- Tre përfaqësues të stafit akademik të angazhuar në programin që i nënshtrohet procesit të akreditimit
- Një përfaqësues nga studentët i angazhuar në programin që i nënshtrohet procesit të akreditimit
- Një përfaqësues i jashtëm nga institucionet partnere
- Koordinatorin institucional

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm harton RVB-në për akreditimin e programeve të studimit dhe kryen këto funksione :

- a) Vlerëson, duke u bazuar në strukturën dhe formatin e përcaktuar nga NjBSC-ja, dosjen e programit.
- b) Vlerëson rregulloren, procedurat dhe zbatueshmërinë e programit të studimit.
- c) Vlerëson elementet didaktike dhe realizimin e objektivave të programit të studimit.
- d) Vlerëson shpërndarjen e krediteve për disiplinat dhe/ose grup-disiplinat në programin e studimit.
- e) Vlerëson elementët përbërës të disiplinave dhe ndarjen e krediteve ndërmjet tyre duke analizuar edhe raportin leksion/seminare/detyra/laboratore/projekte.
- f) Vlerëson literaturën e përdorur, azhornimin dhe larmishmërinë e literaturës.
- g) Vlerëson procedurat e kontrollit të dijeve dhe analizon rezultatet e kontrollit.
- h) Vlerëson mësimnxënien dhe përfitimet e studentëve nga programi.

Grupet e Vlerësimit të Brendshëm në fakultete duhet të raportojnë në mënyrë periodike, dhe sa herë të kërkohet informacion apo të dhëna të tjera nga NjSBC-ja.



## PJESA E KATËRT METODOLOGJIA E VETËVLERËSIMIT

Neni 13

### **Metodologjia**

Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të shumta dhe të ndryshme rreth programeve arsimore, me qëllimin e përmirësimit të mësimnxënies së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standardeve akademike dhe të mësimdhënies.

Vetëvlerësimi është një proces i kryer nga NjBSC ndaj funksionimit të institucionit ose një program akademik me qëllim vlerësimin e shërbimeve arsimore të ofruara, si dhe për të evidentuar nëse programet akademike plotësojnë objektivat e tyre arsimore, ka përputhje me rezultatet, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të programeve dhe zhvillimin e mëtejshëm të procesit të mësimnxënies së studentëve.

Me një sistem të sigurimit të cilësisë (dhe modelet e cilësisë në përgjithësi), UAMD përcakton marrëveshjet e saj, direktivat e zhvillimit, objektivat dhe fushat e përmirësimit dhe përcakton gjithashtu proceset e saj kryesore të sigurimit të cilësisë. Ky proces i brendshëm i cilësisë përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese. Përveç monitorimit të rregullt (çdo vit dhe pjesërisht edhe çdo semestër) dhe përmirësimit, baza kryesore e këtyre aktiviteteve janë vetëvlerësimet që mund të zhvillohen së paku çdo gjashtë vjet në funksion të proceseve të akreditimit nga ASCAL.

Në rastin e akreditimit të programeve të studimit raportet e vetëvlerësimit hartohen nga GVB-ja në nivel programi, ndërsa në rastin e akreditimit institucional nga GVB e ngritur në nivel institucioni. (Për më tepër shih Aneksin I)

Neni 14

### **Qëllimi i vetëvlerësimit**

Qëllimet e vetëvlerësimit janë si më poshtë:

- Të evidentohet arritja e qëllimeve, objektivave dhe synimeve mbi përmbajtjen, politikat, procedurat, shërbimet, mjedisin organizativ dhe intelektual, si dhe performancën e programit dhe/ose institucionit.

- Të nxitet angazhimi me anë të zbatimit të përmirësimeve të rekomanduara nëpërmjet pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në aktivitetin akademik
- Të përmirësohet kapaciteti i programit ose institucionit për vetëvlerësim të vazhdueshëm.
- Të krijohet baza për vendimarrje (dhe planifikim) të fokusuar rreth të ardhmes së programeve të studimit dhe njësive bazë.
- Të përgatiten materiale të shkruara që mund të përdoren si bazë e rishikimit të jashtëm nga ASCAL dhe rishikim nga ekspertët e tjerë brenda institucionit ose sistemit të jashtëm.

## Neni 15

### **Rezultati i vetëvlerësimit**

Rezultatet e vetëvlerësimit jepen përmes një raporti të shkruar. Me qëllim vlerësimin e elementëve të ndryshëm për nivelin e tyre të plotësimit të standardeve të cilësisë, përdoren standarde përkatëse për çdo fushë që vlerësohet. Realizimi i standardit arrihet përmes përmbushjes së kriterëve përkatëse të cilësisë. Vetëvlerësimi është pjesë kryesore e përmirësimit të vazhdueshëm të të gjithë institucionit dhe përbën bazën e vlerësimit, si në nivel të brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm. Për të iniciuar një vetëvlerësim, NjBSC duhet të parashikojë hapat e mëposhtëm:

- **Identifikimin e qëllimit** – Përse duhet të angazhohemi në vetëvlerësim?
- **Identifikimi i rezultateve** – Cilat rezultate duhet të arrijmë me vetëvlerësimin?
- **Masat dhe hartimi i vlerësimit** – Cilat metodologji, instrumente dhe mekanizma duhet të përdorim?
- **Mbledhja e të dhënave** – Cilat lloje të dhënash duhet të mblidhen?
- **Analiza dhe vlerësimi** – Cilat janë metodat që duhet të zbatohet për analizimin e të dhënave?
- **Vendimmarrja në lidhje me masat që duhet të merren** - Si do të përdoren rezultatet e analizës në vendimarrje në lidhje me strategjitë dhe zhvillimet e reja?

## PJESA E PESTË

### TË DHËNAT STATISTIKORE DHE TREGUESIT KYÇ TË PERFORMANCËS (TKP)

#### Neni 16

#### Të dhënat statistikore

**DKSC** përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme mbi institucionin dhe mbledh të dhëna nga NjBSC-të në nivel Fakulteti dhe Koordinatorët e Programeve. Të dhënat kryesore statistikore përfshijnë, por nuk kufizohen në (për më tepër shih aneksin II):

- Ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit;
- mundësitë e punësimit të të diplomuarve;
- profilin e popullatës studentore;
- raportin pedagog/studentë;
- plotësimi i kërkesave të studentëve me programet e tyre;
- efektivitetin e pedagogëve;
- koston e burimeve të mësimnxënies dhe disponueshmërinë e tyre;
- monitorimin e situatës së punësimit të të diplomuarve;
- nivelin e largimit/transferimit të studentëve ;
- numrin i stafit dhe studentëve që pranohen dhe largohen;
- treguesit kyç të performancës së institucionit dhe elementë të ngjashëm.

NjBSC-ja bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të institucionit për të dhënat statistikore që do të parashikonte një analizë sistematike të këtyre treguesve. Strukturat e ndryshme të SBSC-së kryejnë mbledhjen e të dhënave, në varësi të llojit të informacionit të kërkuar dhe analiza përcillet në DKSC. Të dhënat mund të përfshijnë sa më poshtë:

- Ndjekja e të diplomuarve për të gjitha programet dhe nivelet nëpërmjet studimeve vjetore për të analizuar kohën që u duhej studentëve të gjenin një punë dhe në cilin nivel, pagat e tyre, sa të kënaqur janë në punën dhe arsimin e tyre etj. Këto të dhëna analizohen për të nxjerrë një listë të të punësuarve, me qëllim për të ndihmuar studentët aktualë të planifikojnë të ardhmen e tyre profesionale. Kjo qasje lejon analizimin e përshtatshmërisë së ofertës arsimore me mundësitë e punësimit të të diplomuarve;
- Vlerësimet vjetore të studentëve në bazë programi dhe niveli studimi;
- Mbledhja e të dhënave vjetore të të gjitha programeve të studimit mbi bazën e një grupi treguesish;

- Analiza e të dhënave sociale dhe financiare duke përfshirë por pa u limituar tek grantet studentore dhe strehimi;

## Neni 17

### **Treguesit kyç të performancës**

Një prej instrumenteve për analizimin e arritjeve të misionit institucional është përcaktimi i një grupi treguesish kyç të performancës (TKP), për të analizuar kontributin e tyre ndaj arritjes së objektivave strategjike institucionale. Lista e TKP-së realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik nga KPGSC-ja .

TKP-ja përfshijnë elementë si :

- Ruajtja e nivelit të regjistrimeve, nivelet e kalueshmërisë, nivelet e diplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj. Këto të dhëna mblidhen në nivel fakulteti dhe i dërgohen NjBSC-së, çdo fillim viti akademik. Më tej ajo ka për detyrë të japë mendim në formën e sugjerimeve dhe masave korigjuese. Të dhënat, sugjerimet dhe masat korigjuese shqyrtohen nga KPGSC-ja, dhe më pas i propozohen Senatit Akademik për miratim.

Dekanët e fakulteteve, në konsultim me stafin akademik të çdo departamenti, përcaktojnë prioritetet e fakulteteve për t'i renditur me prioritetet e universitetit. Instrument tjetër që ofron të dhëna të rëndësishme mbi një sërë treguesish të performancës duhet të jetë rishikimi vjetor i veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore përgatitur nga DKSC-ja dhe miratuar nga NJSBC i cili përfshin, por nuk kufizohet në numrin e studentëve që diplomohen, numrin e publikimeve dhe kërkimeve shkencore, mënyrën sesi funksionon sistemi i sigurimit të cilësisë, si dhe çdo ankesë për funksionimin e sistemit. Ky është një instrument i dobishëm për NjBSC-në, KPGSC-në dhe Senatit Akademik për shqyrtimin e fushave problematike dhe marrjen e vendimeve rreth alokimit të burimeve dhe zhvillimeve të ardhshme.

PJESA E GJASHTË  
**AKREDITIMI, AFATET DHE PROCEDURAT**

Neni 18

**Llojet e Akreditimit**

IAL-të i nënshtrohen dy niveleve të akreditimit:

1. Akreditimi institucional, që është proces i çertifikimit të veprimtarisë dhe strukturave të institucionit;
2. Akreditimi i programeve të studimit që është proces i çertifikimit të cilësisë së tyre në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

Neni 19

**Afatet e Akreditimit**

Akreditimi i parë institucional dhe ai i programeve, kryhen në bazë të legjislacionit shqiptar para lëshimit të diplomave të para nga institucioni për programet e reja dhe në mënyrë periodike për programet ekzistuese.

Vlefshmëria e çdo akreditimi institucional dhe programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet.

Neni 20

**Procedurat e Akreditimit**

Çdo proces akreditimi ndahet nga NjBSC në disa faza:

**- Faza e parë:** Aplikimi për akreditim

Shqyrtohet aplikimi për akreditim, përputhshmëria ligjore, miratohet kërkesa, njoftohet ASCAL. Kërkesa dorëzohet së bashku me formularin për akreditimin institucional, brenda periudhës 1 nëntor– 30 maj të vitit akademik.

**– Faza e dytë:** Procesi i vlerësimit të brendshëm

NjBSC në nivel institucional i kërkon NjBSC në nivel fakulteti që t'i propozojë dekanit të fakultetit ngritjen e GVB dhe përbërjen e tij. GVB me asistencën e koordinorit të programit dhe

NjBSC ne nivel fakulteti, hartojnë Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) i cili i dorëzohet NjBSC në nivel institucional që realizon dorëzimin e DA në ASCAL (përmes koordinatorit institucional) pas miratimit në Senatin Akademik.

– **Faza e tretë:** Vlerësimi i Jashtëm

ASCAL realizon ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), siguron trainimin, vizitat në institucion, hartimin e draft-raportit të vlerësimit të jashtëm dhe raportit final.

– **Faza e katërt:** Shqyrtimi final dhe vendimmarrja

Kjo fazë fokusohet në përgatitjen e materialeve për Komisionin e Akreditimit (KA), shqyrtimin e tyre nga KA, vendimmarrja, vendimi final nga MASR, publikimi i vendimeve dhe informacioneve.

- **Faza e pestë:** Është faza pas akreditimit

Kjo fazë realizohet ndërmjet dy akreditimeve periodike dhe konsiston në aktivitetet që realizohen në secilën fazë siç pasqyrohen në Manualin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.

## Aneksi I

# MODEL RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRËNDSHËM PËR PROGRAMET E STUDIMIT

## I. PARIMET E PUNËS

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL.
- Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tablo e qartë dhe transparente e Njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumenta, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

## II. ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRËNDSHËM NGA IAL

1. Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit;
2. Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL dhe BA;
3. Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm. ky grup ngrihet nga titullari i njësisë;
4. Trainimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit;
5. Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzuesit në fjalë (shih më tej). Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkesë;
6. Përgatitja e Dosjes së Vetëvlerësimit;

7. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) sipas kërkesave e udhëzimeve në këtë udhëzues dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me stafin e njësisë;
8. Dorëzimi në ASCAL i RVB, (në rastin kur ky proces kryhet si pjesë e vlerësimit dhe akreditimit periodik);

### **III.DOSJA E VETËVLERËSIMIT**

Në përbërje të Dosjes së Vetëvlerësimit përfshihet: *Mendimi me shkrim i Drejtuesit të Njesisë dhe Raporti i Vlerësimit të Brendshëm*, i shkruar nga GVB.

Kërkohe mendimi i drejtuesit të Njesisë, kur Programi i studimit po kalon fazën e rivlerësimit periodik. Në këtë rast ai do të shkruajë:

- Të dhëna për Institucionin e Arsimit të Lartë që ai drejton
- Të japë opinionet e veta personale ku të tregohen vlerat e forta, dobësitë dhe perspektiva e programit të studimit për të cilën është përgjegjës;
- Të analizojë zhvillimet kryesore që nga vlerësimi i fundit, duke theksuar sidomos përmbushjen e detyrave të lëna nga vlerësimet e mëparshme;
- Të tregojë gjendjen ekzistuese në raport me atë që programi/et e studimit, ka për mision ose synon të arrijë.

Raporti Vlerësimit të Brendshëm duhet të përmbajë vlerësimin e GVB për këto çështje:

**A) PROGRAMI I STUDIMIT, MISIONI, ADMINISTRIMI**

**B) POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

**C) KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

RVB përbëhet nga *11 Rubrika kryesore*. Çdo rubrikë që kërkohe të analizohet zakonisht përbëhet nga tre pjesë:

- ❖ Pjesa përshkimore
- ❖ Pjesa e treguesve të matshëm (Tabelat, shoqëruar me Anekset).
- ❖ Vlerësimi sipas Standardeve

Në pjesën përshkimore, GVB sipas termave të referencës përshkruan aspektin përkatës të vlerësimit. Në pjesën e treguesve të matshëm GVB do të japë të dhëna sasiore, tabela etj, të cilat vërtetojnë përfundimet e pjesës përshkimore. Ndërsa në pjesën e vlerësimit cilësor sipas standardeve GVB do të përgjigjet konkretisht për çdo kriter dhe për çdo standard, nëse plotësohet apo jo.



---

## **RAPORT I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM**

### **Për Programin e studimit BSc.....**

#### **1. HYRJE**

(Background për IAL/Programin e studimit që vlerësohet -----)

(Tekst) .....

#### **GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM (GVB)**

Përbërja e GVB:

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....

Shënim: Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet nën përgjegjësinë e titullarit të njësisë, pasi ky i fundit merr mendimin e organit vendimmarrës përkatës. Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB duhen patur parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit, përfaqësimin në grup të sa më shumë opinioneve të njësisë duke evituar në maksimum përfshirjen në të, të personave konfliktualë ose koniukturalë. Grupi, si rregull ka në përbërje të tij 3-5 punonjës të njësisë. Grupi ngrihet qëllimisht për misionin e vlerësimit (grup ad hoc). Ai përcakton një strukturë organizative (drejtuesi, sekretari etj.) dhe një shpërndarje të detyrave. Është e domosdoshme që në GVB të përfshihen dhe përfaqësues të studentëve.

## PROGRAMI/ET E STUDIMEVE, MISIONI, ADMINISTRIMI

### 1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit, mësimdhënia dhe kërkimi shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (historiku, numri i punonjësve në vite, numri i studentëve në vite, vendi i Programit të studimit në kuadrin kombëtar e ndërkombëtar.

(Tekst) .....

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në	

<sup>1</sup> GVB duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	
<b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare</b>	

<b>dhe interesave kombëtare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare; <b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	
<b><u>Konkluzione të GVB:</u></b>	

## 2.Struktura akademike e Fakultetit /Departamentit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Organigrama (Strukturat akademike të Fakultetit, ndarja në Departamente), të dhëna për ndarjen e personelit në këto njësi bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ, koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera.

(Tekst) .....

### Tregues të matshëm:

- Struktura didaktike (Departamentet) për programin e studimit

(tekst pershkrues ose grafik)

- Numri i Personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat, (shih Tabelën 1)

Tabela 1

IAL	Fakulteti .....						
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Total
	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	
Departamenti 1							

Departamenti 2							
Departamenti 3							
....							
Në total							

- Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) të Departamenteve  
(Plotëso Tabelat 2)

Tabela 2

Fakulteti ..... Departamenti 1							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1				1			
2				2			
...				...			
Fakulteti ..... Departamenti 2							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1				1			
2				2			
Fakulteti ..... Departamenti 3							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1				1			
2				2			
...				...			

...				...			
-----	--	--	--	-----	--	--	--

(shënim: Tabela do të plotësohet, aq vite akademike sa kanë kaluar nga hapja e programit)

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit/Koordinatori/ët e programit të studimit  
(ploteso Tabelën 3)

Tabela 3

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor

- Dokumentacioni përkatës

### 3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

#### Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe ndihmës akademik për programin e studimit (plotëso Tabelen 4)

Tabela 4

Stafi akademik i programit të studimit per vitin akademik ..... - .....					
PAE (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1			1		

2				2			
...							

(shënim: Tabelat do të plotësohen për vitet akademike në të cilat programi ka qene aktiv)

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (plotëso Tabelën 5)

Tabela 5

Titulli	Stafi akademik i programit të studimit		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë			
Profesorë të As.			
Dr/PhD			
Pedagogë ne proces Dr			
Asistentë me Msc			
Personeli ndihmës akademik			
Totali			

(shënim: Tabelat do të plotësohen për vitet akademike në të cilat programi ka qene aktiv)

- Të dhëna sipas moshës (plotëso Tabelat 6)

Tabela 6/1

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAE dhe PA me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë					
Profesorë të As.					
Dr/PhD					
Pedagogë ne proces Dr					
Asistentë me Msc					
Personeli ndihmës akademik					

Totali					
--------	--	--	--	--	--

Tabela 6/2

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë					
Profesorë të As.					
Dr/PhD					
Pedagogë ne proces Dr					
Asistentë me Msc					
Personeli ndihmës akademik					

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

(shënim: Tabelat do të plotësohen për vitet akademike në të cilat programi ka qene aktiv)

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

